



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e LjUBLANËS), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0650

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Agon Ramadani - Kryetar, Vjosa Gradinaj - Mexhuani dhe Vedat Poterqoi - Anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së OE "Agrium" SH.P.K.", kundër Njoftimit për kontratë ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me kontejner për mbeturina" me numër të prokurimit 616-23-7124-1-1-1, të Komunës së Prishtinës në cilësi të Autoritetit Kontraktues (AK), më 26/10/2023, mori këtë:

Vendim

- Aprovohet**, si e bazuar ankesa e "AGRIUM" SH.P.K. me nr. 2023/0650, e datës 02/09/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me kontejner për mbeturina", me numër të prokurimit 616-23-7124-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES.
- Anulohet** njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me kontejner për mbeturina", me numër të prokurimit 616-23-7124-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES. Obligohet AK që të bëjë përmirësimet e nevojshme në dosjen e tenderit sipas arsyetimeve të dhëna nga paneli shqyrtues.
- Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.
- Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.
- OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i deponitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 18.07.2023, ka paraqitur Njoftimin për kontratë- B05, për aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me kontejner për mbeturina" me numër prokurimi: 616-23-7124-1-1-1. B54 Formulari standard për korigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara me datën 29.08.2023.

Me 15.08.2023, OE "Agrium" shpk ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. Ndërsa me 24.08.2023, AK ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik ankues si të pabazuar.

Operatori ekonomik "Agrium" shpk i pakënaqur me Vendimin e AK-së, me 02.09.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është regjistruar me numër protokolli 650/23.

- Gjatë fazës së shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues konstatoi se ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë në OSHP pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesit e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se e njëjta i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe bien nën kompetencat e këtij Organi, në kuptim të nenit 105, të LPP.

Paneli Shqyrtues ka konstatuar po ashtu se nuk ekzistojnë rrethana të konfliktit të interesit në kuptim të nenit 11 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me nenin 4 paragrafin 1 nën paragrafin 75 të LPP.

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues dhe ka caktuar po ashtu ekspertin vlerësues, sikurse parashihet me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 22.09.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportet e vlerësimit me rekomandimet:

- Ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar,
- Të anulohet vendimi i AK-së dhe nëse AK ka edhe më tej interes, aktivitetin ta ritenderoj.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. Autoriteti Kontraktues ka njoftuar Panelin Shqyrtues se nuk pajtohet me rekomandimet e ekspertit ndërsa Operatori Ekonomik Ankues ka njoftuar se pajtohet pjesërisht me rekomandimet e ekspertit shqyrtues.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër (faktet dhe rrethanat procedurale) nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtruesit e

palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritot sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

Pretendimet e Ankuesit “Agrium” shpk

- *Pretendimi i parë (I)*- Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër njoftimit për kontratë (kriterëve), kundër kërkesave të vendosura në FTD përkatësisht kërkesave tek “Kapaciteti teknik dhe profesional”, ku OE potencon se AK ka kërkuar nga OE-të të furnizojnë me produktin 1&2 (Kontejner 1100L Metalik dhe Plastik) duke specifikuar dimensionet të veçanta: Gjerësinë (Ë) 1,370 +/-10mm/Lartësia (H) 1,205 +/-10mm, Thellësia (D) 1,060 +/-10mm; me një tolerancë prej +/-10mm, në të njëjtën kohë ka kërkuar të jenë të prodhuara në bazë të standardit Evropian adekuat EN 840-2. OE ankues pretendon se autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 28.2.7 dhe nenin 51 të LPP-së. AK-Komuna e Prishtinës, ka publikuar njoftimin për kontratë me datë 18.07.2023, tek pika 16.1 e dosjes së tenderit, AK ka përcaktuar datën për sqarimin e tenderit deri me 18.08.2023, kurse data e hapjes së ofertave është përcaktuar që të bëhet me datë 28.08.2023. OE ankues, ka paraqit kërkesë për informacion shtesë duke kërkuar informacione sqaruese lidhur me shtatë pika të dosjes së tenderit, ku nder të tjerat kishte kërkuar nga Autoriteti Kontraktues që të mos përcaktohen dimensionet e kontejnerëve por ta kërkoj vetëm standardin EN 840-2, pasi që është në kundërshtim vendosja e dimensioneve me tolerancë aq të vogël prej +/-10mm, e cila i bie 1cm është tejet e vogël dhe me të cilën automatikisht favorizohen prodhuesit të caktuar të konteinerëve, ku po ashtu çdo prodhues në Evropë prodhon kontejner me përputhshmërinë të plotë me certifikatën DIN EN 840-2, po ashtu kishte kërkuar që tolerance prej +/-10mm të behet prej (+/-15mm-30mm).
- *Pretendimi i dytë (II)*- Organizatat të cilat kanë ndikim më së shumti në vend sa i përket menagjimit të mbeturinave si dhe asistancave teknike si “GIZ” asnjëherë nuk vendosin dimensionet specifike të konteinerëve por vetëm kërkojnë të jenë të prodhuara në bazë të standardit EN.
- *Pretendimi i tretë (III)*- AK nuk e ka bërë të qartë se kontejnerët në pozicionin 1 dhe 2, se a janë kontejner me kapak të rrumbullakët apo të rrafshët, standardi EN 840-2 është i përpiluar për kapak të rrafshët. Gjithashtu, në produktin 1 dhe në bazë të dimensioneve kuptohet që është fjala për kapak të rrafshët por tek produkti 2, i cili është kontejner metalik, në bazë të dimensioneve nënkuptohet që kontejnerët janë me kapak të rrumbullakët, ndërsa është kërkuar standardi DIN EN 840-2, ku standardi EN 840-3 është përpiluar për kontejner me kapak të rrumbullakët dhe AK me qëllim ka bërë këtë huti duke mos i specifikuar kapakët në specifikacionin teknike dhe kur të vije puna e dorëzimit të mostrës para mbylljes së tenderit të thuhet se është bërë fjala për kontejner të rrumbullakët në produktin 2.

Konstatimet e ekspertit shqyrtues për ankesën 650/23

- *Konstatimi i parë (I)*- Ekspertja shqyrtuese sqaron se në kërkesën për sqarime të tenderit drejtuar AK-së ishin shtatë (7) pika nga operator ekonomik ankues përderisa kërkoheshin edhe sqarime shtesë për dosjen e tenderit nga operatorët të ndryshëm të interesuar, ndërsa ankesa e parashtruar në OSHP ka të bëjë vetëm me tolerancën e dimensioneve që ndërlidhet me certifikatën DIN EN 840-2 dhe mos përcaktimin e formës së kapakëve të konteinerëve në DT. Rrjedhimisht, me ankesën e parashtruar dhe këtë raport të ekspertizës do të flasim vetëm për këto dy pika. OE ankues me datë 15.08.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim, ndërsa

AK me datë 24.08.2022 ka nxjerr vendim, duke e refuzuar kërkesën për rishqyrtim të OE ankues.

- *Konstatimi i dytë (II)*- Lidhur me pretendimet e OE ankues se AK ka kërkuar që kontejnerët të jenë konform standardit DIN EN 840-2 dhe njëkohësisht duke kërkuar dimensione specifike, kjo kërkesë është e pa logjikshme, diskriminuese/favorizuese dhe kufizuese, ku OE me ankesë ka bashkangjitur skicën e standardit EN 840-2. Po ashtu, OE ankues potencon se edhe organizatat të cilat kanë ndikim më së shumti në vendet sa i përket menaxhimit të mbeturinave, si dhe asistenca teknike si GIZ asnjëherë nuk vendosin dimensione specifike të kontejnerëve por vetëm kërkojnë të jenë të prodhuara në bazë të standardit EN 840. I njëjti ka bashkangjitur prova me ankesë me numër te projekteve. Ekspertja shqyrtuese pas shqyrtimit të pretendimit ankimor, shqyrtimit të standardit EN 840-2 dhe krahasimit të kërkesës së DT-së, sqaron se dimensionet e vendosura nga AK në përshkrimin e punëve tek paramasa e Autoritet Kontraktues nuk janë në përputhje me standardin DIN EN 840-2. AK në Përshkrimi i punëve tek paramasa e Autoritet Kontraktues ka përcaktuar këto kritere të kontejnerëve: DIN EN 840-2: paramasat Gjerësinë (W) 1,370 +/-10mm/Lartësia (H) 1,205 +/-10mm, Thellësia (D) 1,060 +/-10mm; vëllimi nominal 1.100 prej +/- 5%, ngarkesa kg 440/ rrota +/- mm 200. Kurse, sipas skicës së dhënë me sqarime në standardin DIN E 840-2, janë dhënë këto dimensione: (shih linkun) <https://www.sturdyproducts.com/wp-content/uploads/2020/10/BS-EN-840-2.2004.pdf>. Pas krahasimit të kërkesave të vendosura nga AK me standardin DIN EN 840-2, shihet që dimensionet e përcaktuara nga AK janë në kundërshtim me nenin 5 (Specifikimet teknike) të Udhëzues Nr-001_2023. Në nenin 5, par. 5.3 të këtij Udhëzuesi jepen sqarim se një specifikim teknik duhet ti referohet standardeve të mirënjohura. Në sqarimet e dhëna në këtë dispozitë ligjore ceket hierarkia e standardeve që duhet ti referohet AK gjatë formulimit të specifikimeve teknike, ku standardi i parë është një standard i Kosovës që implementon një standard të Evropës, kurse hapi i dytë është një standard Evropian. Në këtë kuptim, vlen standardi DIN EN 840-2. Andaj, ekspertja shqyrtuese konsideron se AK gjatë përpilimit të specifikimeve teknike të kontejnerëve duhet ti përmbahet dimensioneve të përcaktuara në standardin DIN EN 840-2, duke pasur një prag minimal dhe prag maksimal apo me lejime të ndryshimit +/- sipas udhëzimeve në standardin DIN EN 840-2, në atë mënyrë që specifikimet teknike të mos jenë në kundërshtim me këtë standard.
- *Konstatimi i tretë (III)*- Lidhur me pretendimin se AK nuk e ka bërë të qartë se kontejnerët në pozicionin 1 dhe 2, se a janë kontejner me kapak të rrumbullakët apo të rrafshët, standardi EN 840-2 është i përpiluar për kapak të rrafshët. Gjithashtu, në produktin 1 dhe në bazë të dimensioneve kuptohet që është fjala për kapak të rrafshët por tek produkti 2, i cili është kontejner metalik, në bazë të dimensioneve nënkuptohet që kontejnerët janë me kapak të rrumbullakët, ndërsa është kërkuar standardi DIN EN 840-2, ku standardi EN 840-3 është përpiluar për kontejner me kapak të rrumbullakët dhe AK me qëllim ka bërë këtë huti duke mos i specifikuar kapakët në specifikacionin teknike dhe kur të vije puna e dorëzimit të mostrës para mbylljes së tenderit të thuhet se është bërë fjala për kontejner të rrumbullakët në produktin 2. Ekspertja shqyrtuese sqaron se në përshkrim të produktit nuk ceket lloji i kapakut as në pozicionin 1 dhe as në pozicionin numër 2, ajo që ceket në të dy pozicionet është standardi DIN EN 840-2, ku dimensionet janë të njëjta në dy pozicionet por dallon lloji i materialit, ku në pozicionin numër 1 është kërkuar kontejner plastike ndërsa në pozicionin numër 2 është kërkuar kontejner nga materiali i metalit me mbrojtje nga korrozioni, por te pozicioni numër 2 nuk është dhënë informacion për vëllimin në litra sikurse është dhënë informacioni te pozicioni numër 1 prej 1100 litra. Sa i përket pikës ankimore të formës së kapakut, ekspertja shqyrtuese sqaron se askund nuk ceket lloji apo forma e kapakut, por

pretendimi i OE ankues ka të bëjë me parashikim se çfarë mund të ndodh gjatë pranid-dorëzimit të mostrave. Andaj, ekspertja shqyrtuese konsideron se pretendimi ankimor mund të jetë i pranueshëm sepse AK është i obliguar që të specifikoj në detaje dhe të mos lerë hapësirë për interpretime apo vlerësime të ndryshme. Ky obligim ligjor buron nga Rregullorja Nr.001_2022 për prokurimin publik, neni 17.12, ku potencohet se “Çdo fjali në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është materiali themelor, në bazë të cilit Operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre. Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë të tillë, që – si rregull parimor – të mos ketë nevojë për informata sqaruese shtesë.”. Përfundimisht, sipas asaj që u përshkrua si me larte, ekspertja shqyrtuese vlerëson se AK në mënyrën si ka përpiluar paramasën është e pamundur që të arrihet përmbushja e nevojave sipas vlerësimit formal me rastin e inicimit të këtij aktiviteti të prokurimit. Andaj rekomandimi ynë është se ky aktivitet i prokurimit duhet të anulohet në tërësi dhe nëse i njëjti ri tenderohet sugjeroj autoritetin kontraktues të hartoj kërkesa të qarta dhe të përcaktoj çdo kërkesë në dosjen e tenderit (të përcaktoj formën e kapakëve të kontejnerëve) dhe ti harmonizoj dimensionet me standardin Evropian në kuptim të nenit 28 të LPP-së si dhe neni 19 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim publik. Duke vepruar në kuptim të nenit 6, 7 dhe 51 të LPP-së, për ta zgjeruar konkurrencën sipas parimeve kryesore të prokurimit publik që tu mundësohet pjesëmarrje sa më e gjere operatorëve ekonomik te interesuar, dhe që kërkesat të jenë relevante e proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse rekomandoj që kjo lëndë të ri tenderohet.

Konstatimet e Panelit Shqyrtues

Paneli në këtë rast mori në konsideratë të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK dhe raportin e ekspertit dhe vlerëson se ankesa e OE “Agrium” SHPK është e bazuar.

Në fakt Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në këtë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik, andaj paneli mbështet raportin e ekspertizës që në përgjithësi ka konstatuar se kriteret e përpiluara janë të paqarta, mund të jenë diskriminuese si dhe mund të ketë ngushtim konkurrence e poashtu edhe vështirësi në vlerësim të ofertave, ndërsa paneli nuk pajtohet me rekomandimin që aktiviteti të anulohet në tërësi për faktin se DT mund të ndryshohet dhe të përditësohet, megjithatë mbetet në diskrecion të AK-së të vërtetojë saktë se a mund të implementohen rekomandimet e ekspertit në DT konkrete në tërësi në të kundërtën nëse është i nevojshëm anulimi i tërësishëm të argumentohet me arsye objektive dhe të qarta që kjo të arrihet konform dispozitave ligjore në fuqi, duke konsideruar nenin 62 të LPP-së, gjithashtu duke u bazuar në tiparet themelore të LPP-së që janë ekonomiciteti efikasiteti si dhe qëllimin që procedura të përfundojë në afate më të shpejta konform kërkesave dhe nevojave të AK-së.

Vlen të theksohet se me datë 23.10.2023 OSHP ka pranuar një shkresë nga ana e AK-së, me përmbajtjen si në vijim:

“TE nderuar, Zyra e prokurimit pas pergjigjes per raportin e ekspertit lidhur me ankesen me numer 2023/0650 per aktivitetin e prokurimit: Furnizimi me kontejner për mbeturina, me nr. te prokurimit 616-23-7124-1-1-1 te ngarkuar ne platformen e E-Prokurimit dhe konsultimeve me njesine kerkuese, duke pas parasysh rendësin dhe implementimin sa me te shpejte te këtij aktiviteti pajton qe te beje ndryshimet e nevojshme si ne kriteret e kërkuara na Njoftimin për Kontrate dhe ne Dosjen e tenderit e po ashtu edhe ne specifikimet teknike, andaj AK kerkona nga

ana juaj qe mundesishte sa me shpejt te nxirrni nje vendim ne menyre qe te mund te vazhdojme me aktivitetin e Prokurimit per furnizimin me kontejner per mbeturina."

Lidhur me këtë paneli shqyrtues konform nenit 116 ka kërkuar sqarime si në vijim:

"A pajtoheni me të gjeturat në raportin e ekspertit si dhe rekomandimet lidhur me specifikat teknike, duke nën-kuptuar që kemi pajtim lidhur me pretendimet ankimore përveç rekomandimit për anulim të tërësishëm ndërsa të njëjtat të përmirësohen konform ekspertizës ?"

Nga ana e AK-së është pranuar përgjigjja si në vijim:

"Po ju konfirmojmë se ne pajtueshmëri me njësinë kërkuese e cila i ka hartuar këto specifika ne pajtohem me rekomandimin e ekspertit, ju falënderojmë për bashkëpunimin."

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përdërisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe janë analizuar dhe argumentuar nga ana e këtij Paneli. Prandaj Paneli mbështet shpjegimet e ekspertit shqyrtues i cili ka shpjeguar se në raportin e ekspertizës së tij, gjithashtu sipas komunikimeve të referuara si më lart përveç tjerash mund të evidentohet se kemi pajtim të AK-së dhe OE-së ankues lidhur me të gjeturat e ekspertizës në aspektin e hartimit të DT dhe NJK.

Prandaj bazuar në faktet dhe rrethanat e këtij rasti Paneli Shqyrtues konstaton se Autoriteti Kontraktues në kundërshtim me dispozitat ligjore, ka hartuar specifikat e dosjes së tenderit duke hartuar specifika të paqarta që kanë mundur të orientojnë drejt rrethanave diskriminuese/favorizuese dhe kufizuese,

Paneli shqyrtues poashtu konstaton se në përshkrim të produktit nuk ceket lloji i kapakut për pozicionin 1 dhe as për pozicionin numër 2. Në të dy pozicionet ceket standardi DIN EN 840-2, ku dimensionet janë të njëjta në dy pozicionet por dallon lloji i materialit. Në pozicionin numër 1 është kërkuar kontejner plastike ndërsa në pozicionin numër 2 është kërkuar kontejner nga materiali i metalit me mbrojtje nga korrozioni, mirëpo te pozicioni numër 2 nuk është dhënë informacion për vëllimin në litra sikurse është dhënë informacioni te pozicioni numër 1 prej 1100 litra. Poashtu, askund nuk është cekur lloji apo forma e kapakut, se kërkohet kontejner me kapak të rrumbullakët apo të rrafshët (standardi EN 840-2 është i përpiluar për kapak të rrafshët).

- Përfundim –

Pas vleresimit perfundimtar te te gjitha provave dhe fakteve paneli shqyrtues konstaton se AK gjatë përpilimit të specifikimeve teknike të kontejnerëve duhet ti përmbahet dimensioneve të përcaktuara në standardin DIN EN 840-2, duke pasur një prag minimal dhe prag maksimal apo me lejime të ndryshimit +/- sipas udhëzimeve në standardin DIN EN 840-2, në atë mënyrë që specifikimet teknike të mos jenë në kundërshtim me këtë standard evropian.

AK është i obliguar që të specifikoj në detaje dhe të mos lerë hapësirë për interpretime apo vlerësime të ndryshme. Ky obligim ligjor buron nga Rregullorja Nr.001_2022 për prokurimin publik, neni 17.12, ku potencohet se "Çdo fjali në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është materiali themelor, në bazë të cilit Operatorët ekonomik do të krijojnë

tenderët e tyre. Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë të tillë, që – si rregull parimor – të mos ketë nevojë për informata sqaruese shtesë.”

Paneli shqyrtues konsideron se vendimi i marrë në këtë çështje është i bazuar në administrimin e të gjitha provave, në dispozicion të kësaj lënde dhe se në marrjen e vendimeve gjithmonë ka parasysh nenin 6, si dhe 1 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese. Paneli Shqyrtues niset gjithnjë nga fakti se autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në detyrimin e tyre eksplicit respektimi i ligjshmërisë në procesin e prokurimit.

Lidhur me tarifën ankimore është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Agon Ramadani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendi mi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - " AGRIMUM " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: